

Mr. Shaban Hashani

RRETHANAT EKONOMIKE, KULTURORE DHE ARSIMORE NË FERIZAJ DHE RRETHINË (1918—1945)

1. Rrethanat ekonomike

Me aktin e unjësimit, prej 1 dhjetorit të vitit 1918, në kuadrin e Mbretërisë SKS u gjetën pesë kombe të formuara: serb, kroat, slloven, maqedon dhe malazez. Në shtetin e ri u gjetën edhe një numër kombesh dhe kombësish të tjera. Së bashku me këtë, si ndër detyrat e para që u imponuan shtetit të ri ishte zgjidhja e çështjes kombëtare dhe sigurimi i zhvillimit kombëtar pa pengesa i të gjitha kombeve dhe kombësive. Nga zgjidhja e drejtë e çështjes kombëtare, si dhe e çështjes agrare e sociale, varej konsolidimi i Mbretërisë SKS si shtet.¹

Vlerësimi i rëndësishë së formimit të Jugosllavisë dhe i karakterit të saj është dhënë në Programin e LKJ-së, i cili u miratua në Kongresin VII të LKJ-së, që u bë prej 22—26 prill të vitit 1958. Në lidhje me formimin e Mbretërisë SKS në Programin e LKJ-së shkruan:

„Jugosllavia u formua pas Luftës së Parë Botërore si rezultat i synimeve shekullore dhe i luftërave të popullit serb, maqedon, malazez, kroat dhe slloven për bashkim, por për një mënyrë që ishte në kundërshtim me parimet demokratike, nën ndikimin e drejtpërdrejtë negativ të fuqive të mëdha imperialiste dhe të interesave klasore të borgjezisë së vendit”.²

Në shtetin jugosllav u bashkuan regjione me një shkallë jo të njëjtë të zhvillimit ekonomik dhe kulturor. Kjo diferencë ishte pasojë e faktit se regjionet e ndryshme u zhvilluan shekuj me radhë në kushte dhe në ndikime të ndryshme. Në tërësi, Jugosllavinë e Vjetër e përbënin regjionet ekonomikisht të pazhvilluara, kurse shkatërrimet në Luftën e Parë Botërore e sollën në një nivel edhe më të ulët ekonomik.³

¹ Juliana Vrčina, *Nашa najnovija istorija*, Beograd, 1967, 5—6.

² *Programi i LKJ-së*, Prishtinë, 1977, 105.

³ *Po aty*, 107.

Njëra ndër viset më të prapambetura ishte krahina e Kosovës. Kjo ishte pasojë jo vetëm e politikës së padrejtë të borgjezisë sunduese serbe, por edhe e prapambetjes së trashëguar ekonomike gjatë sundimit gati pesëshekullor të sistemit ushtarak-spahi osman. Kosova u inkuadrua në shtetin jugosllav me një ekonomi të prapambetur, në të cilën zotëronte tipi natyral i prodhimit. Kalimi nga ekonomia natyrale në atë monetare e pastaj në forma moderne të ekonomisë kapitaliste, u bë shumë ngadalë. Kjo është e kuptueshme kur dihet se borgjezia serbe as nuk kishte fuqi as nuk ishte e interesuar për një zhvillim të shpejtë të ekonomisë kapitaliste në këtë trevë.⁴

Shkurt, për ekonominë e Kosovës në kohën e Jugosllavisë së paraluftës ishte karakteristikë konservimi i bujqësisë së prapambetur, në qytete zejtarët dhe tregtarët ishin faktorë mbizotërues ekonomikë, por një pjesë e konsideruar e popullsisë së qyteteve merrej me bujqësi, industria ishte në embrion, zotëronte tipi natyral i prodhimit. Pra, ekzistonte një prapambetje e madhe ekonomike, megjithëse ekzistonin kushte të volitshme natyrore dhe demografike për zhvillim ekonomik.⁵

Ekonomia e Ferizajt kishte po ato cilësi që ishin karakteristike e ekonomisë së Kosovës.

Ferizaj me rrethinë ishte trevë e prapambetur në pikëpamje ekonomike po për këto arsye që u vunë në dukje është për prapambetjen e Kosovës — shkalla e ulët ekonomike e trashëguar nga periudha e sundimit turk dhe politika e padrejtë që ndiqte borgjezia serbomadhe.

Në mes të dy luftërave botërore ekzistonin vetëm disa ndërmarrje të vogla industriale. Para Luftës së Dytë Botërore bujqësia merrte pjesë me afër 7/10 në realizimin e të ardhurave të tërë popullsisë; industria dhe xehetaria me 1/10; zejtaria dhe tregtia me 2/10, ndërsa afro 9/10 e popullsisë ishin të inkuadruar në bujqësi dhe në kurbet.⁶

Prej objekteve të vogla industriale në Ferizaj ishin fabrika e tjegullave dhe e tullave e Ivan Videkut në fshatin Talinoc dhe ajo „Luboten” e Nikolla Gj. Nikoliqit,⁷ mulliri motorik i Sava Çiqkariqit, mulliri „Kosovo” i J. Popoviqit,⁸ centrali elektrik⁹ dhe xehërorja e kromit „Jezerina”.¹⁰

Fabrika e tjegullave dhe e tullave në fshatin Talinoc u ngrit më 1927, ndërsa leja për punë u dha tek më 18 mars të vitit 1933. Pronar i kësaj ndërmarrjeje ishte Ivan Videk, i lindur në Pragë të Çekosllovakisë, nënshtetas jugosllav. Kapitali i deponuar kapte shumën 3 milionë dinarë. Fabrika kishte një dizelmotor prej 65

⁴ Dr. Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë*, Prishtinë, 1971, 16.

⁵ *Po aty*, 17.

⁶ *Monografia „Ferizaj dhe rrethina”*, Beograd, 1975, 9.

⁷ Milan Gavrilović, *Privreda Južne Srbije*, Skoplje, 1933, 139.

⁸ *Po aty*, 108; Mr. Živojin Denić, *Industrija i rudarstvo Kosova od 1918—1941*, „Kosova”, nr. 1, Prishtinë, 1972, 326.

⁹ Mr. Ž. Denić, *punimi i cit. në „Kosova”* 1, 327.

¹⁰ *Po aty*, 289; *Štrajkovi rudara Srbije* (zbornik radova), Beograd, 1967, 292—295.

kalëfuqi dhe një motor ndihmës prej 41 kalëfuqi. Prodhimi vjetor i kësaj ndërmarrje ishte afro 2 milionë copë tulla dhe nga një milion tjegulla. Gjatë vitit fabrika punonte zakonisht prej 15 prillit deri më 15 tetor. Koha e punës zgjatte nëntë orë. Në drejtori ishin të inkuadruar tre persona, ndërsa numri i punëtorëve ishte afro 80.¹¹

Sipas disa shënimeve del kjo ndërmarrje nuk kishte punuar gjatë viteve 1934, 1936, 1937 dhe 1939. Kapaciteti ditor i prodhimit ishte: 25.000 copë tulla dhe 30.000 copë tjegulla. Pjesa më e madhe e të inkuadruarëve ishin punëtorë sezonalë.¹²

Ndërmarrja tjetër, që prodhonte tulla dhe tjegulla, ishte edhe ajo „Luboten” e Nikolla Gj. Nikoliqit. Kjo ndërmarrje ishte themeluar më 1935. Atëherë kapitali deponues kapte shumën 230.000 dinarë, prej të cilit 100.000 dinarë ishin deponuar në ndërtesa të ndërmarrjes, 80.000 në makina dhe 50.000 në lokalet për terjen e tullave. Puna në këtë ndërmarrje zhvillohej prej fillimit të majit deri në fund të shtatorit. Punohej në një ndërresë. Në këtë ndërmarrje ishin të inkuadruar afro 40 punëtorë, pjesa dërmuese e të cilëve ishte e pakualifikuar. Prodhimi vjetor i kësaj fabrike ishte prej 200.000—400.000 copë tulla dhe tjegulla.¹³

Si objekt industrial për rrethinën e Ferizajt rëndësi të madhe kishte edhe xeherorja e kromit „Jezerina”.

Xeherorja „Jezerina” ishte me lartësi mbidetare më të lartë në Jugosllavinë e Vjetër. Ndodhej në pjesën veriperëndimore të malit Sharr, në një lartësi mbidetare prej 1.800 metrash.¹⁴

Sipas dr. Vasilije Simiqit, xehetaria në terrenin e Lepencit të Epërm filloi qysh në shekullin e kaluar, ndërsa punimet më të hershme filluan në vendin Shalldare. Qysh më 1903 këtu ekzistonin dy vende ku nxirrej xehja: „Ostrovica” dhe „Vërbeshtica”. Pronar i privilegjes „Vërbeshtica” ishin qysh prej vitit 1892 H. Malatoni dhe Mustafa beu. Në fillim të shekullit XX në xeheroren „Vërbeshtica” punuan 50—60 punëtorë të cilët nxirrnin në vit 1.000 tonelata xehë, e cila përmbante 48—49% krom.¹⁵

Nga vitet njëzet të shekullit XX në një terren mjaft të vogël ishin dhënë mjaft koncesione: „Jezerina”, „Ostrovica”, „Mushiti-sht”, „Shtërpce” dhe „Shalldare”. Pesë të parat më vonë u bashkuan në një koncesion të përbashkët — „Jezerina” me 4380 hektarë sipërfaqe, pronar i cilës ishte Mojs Aseo. Për nga rezervat e veta, „Jezerina” ilogaritej xeherorja e tretë e kromit në Jugosllavi. Mendohet se prej themelimit deri në fund të Luftës së Dytë Botërore në „Jezerinë” u prodhuan afro 220.000 tonelata xehë.¹⁶

¹¹ Si shën. 9, 322.

¹² *Po aty*.

¹³ *Po aty*, 322—323.

¹⁴ Branko Djurić, *Borba rudara Srërije za životne i radne uslove i za politička prava od 1929—1941 godine*, në librin Štrajkovi rudara Srërije, RAD, Beograd, 1967, 292.

¹⁵ Dr. Vasilije Simić, *Istorijski razvoj našeg rudarstva*, Beograd, 1951. (Cituar sipas Mr. Ž. Denić, pun. në „Kosova”, I, 289).

¹⁶ *Proizvodne snage NR Srërije*, Beograd, 1950, 345.

Ja disa shënime mbi lëvizjen e prodhimitarisë dhe të nunrit të të inkuadruarve në xeheroren „Jezerina”.¹⁷

- më 1932 u prodhuan 5468 tonelata, të inkuadruar 87 punëtorë,
- më 1934 u prodhuan 9955 tonelata, të inkuadruar 88 punëtorë,
- më 1935 u prodhuan 12288 tonelata, të inkuadruar 121 punëtorë,
- më 1937 u prodhuan 10367 tonelata, të inkuadruar 121 punëtorë,

Po ashtu edhe për xeheroren „Shalldare” ekzistojnë shënime. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 190 hektarësh. Lëvizja e prodhimitarisë së xehes dhe e të të inkuadruarve për disa vite ishte sa vijon:¹⁸

- në vitin 1932 u prodhuan 210 ton., të inkuadruar 8 punëtorë,
- në vitin 1934 janë prodhuar 506 ton., të inkuadruar 9 punëtorë,
- në vitin 1935 janë prodhuar 170 ton., të inkuadruar 7 punëtorë,
- në vitin 1937 dhe 1938 xeherorja nuk ka qenë aktive.

Pos këtyre xeheroreve, që ishin në kuadrin e rrethit të Ferizjës, disa ndërmarrës të këtij qyteti kishin koncesione edhe jashtë Ferizajt. Kështu, xeheroren e magnezitit „Golesh” e eksploatonte firma e përbërë nga Rajko Bakiqi, Todor Sllavkoviqi dhe Stojimir Parliqi, tregtarë nga Ferizaji.¹⁹ Kjo kompani kishte filluar ta eksploatonte xeheroren përkatëse në vitin 1928. Kapitali i deponuar në këtë xeherore ishte 4 milionë dinarë. Në vitin 1933 kapaciteti i kësaj xeherore ishte 7.000—8.000 tonelata. Xehja transportohej nëpër Ferizaj deri në Selanik, ku më tutje eksportohej për në Angli, Gjermani dhe Amerikë.²⁰

Këto ndërmarrje të vogla industriale nuk luajtën rol thelbësor në jetën ekonomike të kësaj treve. Si u pa edhe më lartë, nëpër këto ndërmarrje ishte i inkuadruar një numër mjaft i vogël punëtorësh. Ferizaji dhe rrethina e tij edhe më tej mbetën trevë, ku degët kryesore ekonomike ishin bujqësia, zejtaria dhe tregtia.

Edhe pse Ferizaji nuk kishte ndonjë traditë në zejtari,²¹ këtu ndërmjet dy luftërave zejtaria u zhvillua mjaft. Se sa ishte e zhvi-

¹⁷ *Rudarska i topionička statistika Kraljevine Jugoslavije*, për vitet e përmendura. (Cit. sipas Z. Denić, „Kosova”, nr. 1, 1972).

¹⁸ *Po aty*, 290.

¹⁹ Si shën. 9, 297; Milan Gavrilović, *Privreda Južne Srbije*, Beograd, 1933, 110.

²⁰ M. Gavrilović, *vep.* 118.

²¹ Engjëll Gjini, *Një vështrim për themelimin dhe zhvillimin e Ferizoviqit*, „Përparimi”, nr. 4, 1957, 248.

lluar zejtaria dëshmon fakti se në vitin 1920 Ferizaji kishte 112 punishte zejesh.²² Kur themi se Ferizaji nuk kishte traditë në zeytari, mendohet për periudhën para luftërave ballkanike. Pastaj, ky qytet nuk kishte ndonjë traditë në zeytari në krahasim me qytetet e tjera, siç ishin Prizreni, Gjakova etj. Por, megjithatë, zeytaria e Ferizajt ndërmjet dy luftërave botërore nuk qëndronte aq larg zeytarisë së qyteteve të përmendura.

Një pjesë e konsideruar e popullsisë së Ferizajt merrej me rritjen e kafshëve dhe të shpezëve shtëpiake. Kemi disa shënime për numrin e kafshëve dhe të shpezëve shtëpiake që kishte rrethi i Ferizajt për disa vite ndërmjet dy luftërave. Ky numër ishte sa vijon:²³

Vitet	Kuaj	Gomarë dhe mushka	Gjedhe	Buallica	Dele	Dhi	Derra	Shpezë	Zgjoie blëtësh
1924	771	118	9087	802	15232	5953	734	24175	698
1925	821	123	8578	273	18428	4106	1536	22849	1037
1926	1004	140	10165	622	22303	5173	2056	29597	1309
1927	996	123	9032	461	19861	4227	1759	29037	1307

Kushtet për zhvillimin e blegtorisë ishin mjaft të volitshme kur dihet se një pjesë e kullosave të mira në malin Sharr i takonte rrethit të Ferizajt.

Në Ferizaj ndërmjet dy luftërave ishte e zhvilluar mjaft edhe tregtia. E tërë lënda e parë, sidomos drithi, nga Prizreni, Gora, Rrafshi i Dukagjinit dhe Sredska, për Shkup dhe Selanik, shkante nëpër Ferizaj. Po ashtu edhe mallrat që vinin prej Shkupit dhe Selanikut për Prizren dhe vise të tjera të përmendura, kalonin, po ashtu, nëpër Ferizaj.²⁴

Nëpër stacionin e Ferizajt u eksportuan kaq tonelata drithra:²⁵

- në vitin 1919 2825 tonelata drithra,
- në vitin 1920 6350
- në vitin 1921 6770
- në vitin 1922 5605
- në vitin 1923 1500
- në vitin 1924 7875
- në vitin 1925 9845
- në vitin 1926 10915
- në vitin 1927 9900 tonelata

²² Dr. Fehmi Puškoli, *Revolucionarni sindikalni pokret i Savez sindikata Kosova 1919—1975*, Priština, 1977, 13.

²³ Djordje Krstić, *Kolonizacija u Južnoj Srbiji*, Sarajevo, 1928, 93.

²⁴ Kosta Kostić, *Naši gradovi na jugu*, Beograd, 1922, 107.

²⁵ Si shën. 25, 91.

Vlen të përmendim se oscilimet në sasinë e eksportuar të drithrave ndërmjet viteve të përmendura ishin rezultat i frutit të dobët (1923) dhe i thatësisë së madhe (1927).

Nëpër stacionin e Ferizajt u eksportuan edhe një numër i konsideruar delesh. Edhe për këtë eksport po shërbehemi me disa shënime:²⁶

- në vitin 1919 u eksportuan? (mungojnë të dhënat),
- në vitin 1920 u eksportuan 85 dele,
- në vitin 1921 204
- në vitin 1922, mungojnë të dhënat,
- në vitin 1923 508
- në vitin 1924 7019
- në vitin 1925 6455
- në vitin 1926 9421
- në vitin 1927 20571

Është e nevojshme të ceket fakti se ky numër i eksportuar i deleve nëpër stacionin hekurudhor të Ferizajt nuk buronte vetëm nga rrethi i Ferizajt, por edhe nga qytetet dhe krahinat e tjera që nuk posedonin hekurudhë dhe se Ferizajin e kishin më afër.

Për ekonominë e Ferizajt ndërmjet dy luftërave rëndësi kishin edhe institucionet kreditore — bankat.

Bankat e para në Ferizaj u themeluan pas luftërave ballkanike, kur nga fondi i kishës së shën Uroshit u themelua Banka e Ferizajt. Kjo bankë ndërmjet luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore kishte një kapital prej 200.000 dinarësh.²⁷ Këtë kapital kjo bankë kishte edhe në vitin 1920.²⁸

Me iniciativën e Bankës së Prizrenit dhe të Pejës, më 1923, në Shkup u themelua Banka „Stara Sribija” për të gjitha entet në Serbinë e Vjetër në veri të Kaçanikut.²⁹ Kështu në kuadrin e kësaj banke u inkuadrue edhe Banka e Ferizajt. Në vitin 1924 u themelua Banka Ekonomike e Ferizajt me një kapital prej 1.000.000 dinarësh.³⁰

Pas okupimit të vendit treva e Ferizajt u nda në dy zona okupuese: italiane (pjesa më e madhe) dhe bullgare.

Karakteristikë për zonën okupuese italiane në Kosovë, në të bënte pjesë edhe Ferizaji, ishte edhe ajo që rrethanat ekonomike ishin më të volitshme sesa në zonat e tjera okupuese të kësaj treve.³¹ Okupatori italian paraqitej në mënyrë demagogjike se gjoja dëshironte përmirësimin e gjendjes ekonomike. Kështu, nxiti tregtinë me mallra të konsumit të gjerë, hapi punë publike në ndërtimin e rrugëve, organizoi eksploatimin e pasurive xeherore. Një-

²⁶ Po aty, 92.

²⁷ Milan Čemerikić, *Trgovina, zanatstvo, industrija i kreditne ustanove od 1875—1937*, në *Spomenica 25-godišnjice oslobodjenja Južne Srbije*, Skopje, 1937, 720.

²⁸ Si shën. 20, 155.

²⁹ Po aty; Si shën. 27, 722.

³⁰ Po aty.

³¹ Ali Hadri, *Okupacioni sistem na Kosovu i Me'ohiji 1941—1945*, Jugoslavenski istorijski časopis, nr. 2, Beograd, 1965, 53.

kohësisht fashistët italianë shfrytëzuan intensivisht prodhimet bujqësore, posaçërisht drithin, i cili në këto anë ishte në sasi të madhe, sepse ato vite qenë mjaft të bereçetshme. Për grumbullimin e drithit fashistët italianë kishin shoqri tregtare për blerjen dhe shitjen e drithit, si ishin S.A.S.T.E.B. dhe E.A.G.A.³² Organizata SASTEB duhej ta merrte drithin nga populli dhe t'ia dërgonte okupatorit. Blerja e drithit nga populli bëhej me çmime mjaft të ulëta. Kësaj organizate fashistët italianë i kushtonin rëndësi të posaçme. Një degë e kësaj organizate ishte e hapur edhe në Ferizaj. Që të jetë sa më efikase kjo organizatë, italianët për punë në të zgjedhin vetëm ato persona për të cilët besonin se me shpirt e me zemër i takonin Partisë Fashiste. Prandaj okupatori ishte i sigurt se SASTEB-i do t'i siguronte atij furnizim të mirë.³³ Por, fashistët italianë shpesh mashtroheshin me rastin e emërtimit të personave në vendet udhëheqëse të SASTEB-it. Një gjë e tillë ngjau edhe me degën e kësaj organizate në Ferizaj.

Në fillim të vitit 1942 drejtor i SASTEB-it në Ferizaj u emërua shkodrani Tefik Çanga (prej janarit të vitit 1943 anëtar i PKJ-së — shën. Sh.H.). Udhëheqësia lokale e Partisë Fashiste dhe Komanda e Vendit kishin besim të plotë në të. Por, së shpejti u pa se drejtori i ri i urrente fashistët dhe filloi t'ua shpërndante drithin të varfërve dhe një sasi të dërgonte edhe për nevojat partizane.³⁴

Magazinat e SASTEB-it në Ferizaj ishin ndër institucionet më të rëndësishme të okupatorit. Prej tyre ai i paguante spiunët e vet dhe i furnizonte anëtarët e Partisë Fashiste, nëpunësit dhe ushtrinë. Më anë të Tefik Çangës magazinat e SASTEB-it u shndërruan në bazë për furnizimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe strehimore për punëtorët ilegalë dhe familjet partizane në Ferizaj dhe në rrethinë.³⁵

Politika e grabitjes kolonialiste, që zbatonte pushtuesi, solli edhe keqësimin e mëtejshëm të gjendjes ekonomike të popullit. Iluzioni i mirëqenies që fashistët kishin krijuar në mënyrë artificiale në fillim, ishte zhdukur me kohë. Sipas Buletinit të Çmimeve të Bankës Kombëtare të Shqipërisë, çmimet e mallrave të konsumit (ushqim e veshmbathje) në vitin 1942 ishin rritur deri afro 10 herë. Po ashtu, kostoja e jetës në vitin 1942 ishte rritur 10 herë. Përveç këtyre, pushtuesit fashistë i grabiten fshatarësisë toka për objekte ushtarake, gjënë e gjallë, drithin, leshin dhe pasuritë tjera për të mbajtur ushtrinë e pushtimit.³⁶

Për t'i tërhequr pas vetes agallarët dhe bejlerët, fashistët italianë rimbëmbën sistemin feudal në gjysmën e dytë të vitit 1942. Po ashtu, gjatë viteve 1942 dhe 1943 u vu e dhjeta.³⁷

³² Po aty, 54.

³³ Dragi Ristiç, *Tejik Çanga*, „Në flakën e revolucionit”, II, Prishtinë, 1965, 157.

³⁴ Po aty.

³⁵ Po aty, 161.

³⁶ *Historia e Shqipërisë*, vëll. II (1939—1944), libri 6, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1973, 30—31; *Historia e popullit shqiptar*, vëll. II, Prishtinë, 1969, 678—679.

³⁷ Si shën. 31, 54.

Në zonën tjetër okupuese, në zonën bullgare të territorit të Ferizajt, ekzistonte vetëm një objekt ekonomik, xeherorja e kromit „Jezerina” dhe ajo „Brezovica” mbi Shtërpçë. Edhe pse këto xeherore ishin në zonën okupuese bullgare, eksploatimin e tyre e organizonte, me ndihmën e organizatës TOT, në bazë të marrëveshjes ndërmjet bullgarëve dhe gjermanëve, Shtabi Ushtarako-Drejtimes për Juglindje. Për transportimin e 30.000 tonelatave xehe kromi u ndërtuan 30 km hekurudhë. Po ashtu, u ndërtua dhe u mermetua rruga.³⁸

Pjesëmarrja e xeheve së kromit nga xeherorja „Jezerina” paraqitte 30% të të gjithë sasisë së xeheve të transportuar në Rajhun e Tretë prej Greqisë, Maqedonisë dhe Serbisë. Në këto xeherore ishte i angazhuar grupi i dytë i çetës së dytë të Batalionit Xehetar të Juglindjes i përbërë nga 3 nënoficerë dhe 36 ushtarë. Prodhimi i kësaj xeheroreje në gusht të vitit 1953 ishte 3.000 tonelata xehe të kromit. Në fillim të vitit 1943 eksploatimi i xeheve qe ndërprerë për shkak të dëborës së madhe dhe mungesës së vagonave për transport. Po ashtu, në produktivitetin e kësaj xeheroreje ndikoi edhe burgosja e punëtorëve dhe e nëpunësve të saj, që u bë në prill të vitit 1943 nga ana e policisë bullgare, për shkak të lidhjeve me partizanët. Xeheroren, teleferikun dhe hekurudhën me binarë të ngushtë Brezovicë-Kaçanik e mbronin trupat okupuese bullgare (3 çeta, 4 oficerë, 13 nënoficerë dhe 128 ushtarë të stacionuar në Shtërpçë). Këto trupa okupuese, së bashku me policinë bullgare, në fillim të korrikut të vitit 1943 burgosen te Shtërpça (rajoni i xeherores „Jezerina”) 30 njerëz, prej të cilëve gjatë këtij aksioni bullgarët vranë 6. Në rënien e eksploatimit të xeherores ndikoi edhe mungesa e thëngjillit për lokomotivë. Për këtë arsye komunikacioni në hekurudhën Brezovicë-Kaçanik u ndërpre prej 20 qershorit deri 13 korrik të vitit 1943, derisa arritën dizel lokomotiva për tërheqjen e vagonave.³⁹

Pas kapitullimit të Italisë fashiste u keqësua gjendja në Kosovë. Ky keqësim i gjendjes ekonomike u manifestua edhe në Ferizaj.

Në kohën e pushtimit gjerman ra shumë standardi jetësor, sepse u ngritën çmimet e prodhimeve ushqimore. Tregtarët bënin spekulime jo vetëm me drithra, por edhe me tekstil dhe me produkte të tjera. Në Ferizaj sidomos mori hov tregtia me kripë, e cila me vështirësi merrej përtej kufirit bullgaro-gjerman. Në gjendje të mjerueshme ishte edhe bujqësia, e cila shkaktohte keqësimin e pozitës së bujkut, kurse tregtarët pasuroheshin duke bërë spekulime, që dëmtonin të varfërit.⁴⁰

³⁸ Arkivi i Institutit Ushtarako-Historik, Beograd, NAV—77, r. 1929, 489—92; T—75, r. 69, s. 1—74. (Cituar sipas: Antun Miletić, *Kosova iz aspekta okupacione uprave Vermahta u Srbiji (1941—1944)*, „Kosova”, nr. 4, Prishtinë, 1975, 183.

³⁹ AIUH, NAV-T-77, r. 613, s. 180067—76, 1800158—9, s. 18001607, 1800168—74, 1800189—90. (Cituar sipas A. Miletić, *pun. cit. në „Kosova”*, nr. 4, Prishtinë, 1975, 183—184).

⁴⁰ Dr. Ali Hadri, *Gjakova në LNÇ*, 155.

Pas pushtimit gjerman, në Ferizaj dhe në rrethinë nuk u ndër-
tua asgjë. Sipas të dhënave që disponojmë del se ishte bërë vetëm
një projekt për meremetimin e rrugës së atëhershme të qytetit
„Skënderbeg”.⁴¹ Xeheroren „Jezerina” në Brezovicë gjermanët vazh-
duan ta eksploatonin edhe pas kapitullimit të Italisë. Që eksplo-
atimi i kësaj xeheje të ishte më i madh, gjermanët në qershor të
vitit 1944 hapën tri mihje të reja sipërfaqësore. Prodhimi në këtë
xeherore arriti në 630—720 tonelata xehe. Se sa me intensitet të
madh gjermanët e eksploatonin këtë xeherore, dëshmon shtimi i
numrit të të inkuadruarve gjatë muajve qershor dhe korrik të vi-
tit 1944. Kështu, në qershor gjermanët kishin inkuadruar 209, ndër-
rsa në korrik 224 punëtorë. Këta punëtorë në korrik të njëjtit vit
kishin nxjerrur 2514 tonelata xehe kromi. Eksploatimi i kësaj xe-
heroreje vazhdoi deri në fillim të shtatorit të vitit 1944, kur një-
siti gjerman i përbërë prej një oficeri, 4 nënoficerëve dhe 53 ush-
tarëve, nën presionin e sulmeve të njësiteve të UNÇ-së, u tërhoq
në Ferizaj.⁴²

2. Rrethanat kulturore dhe arsimore

Deri në Vitin 1941, Kosovën e karakterizonte prapambeturia
kulturore dhe arsimore. Kjo ishte po ashtu, si edhe për rrethanat
ekonomike, pasojë e sundimit pesëshekullor të feudalizmit osman,
ashtu edhe e politikës së padrejtë kulturore-arsimore të borgjezi-
së serbe në Mbretërinë e Jugosllavisë.

Nga viti 1918 klasa sunduese hapi shkolla në të cilat mësimi
zhvillohej në gjuhën serbe. Në fillim ekzistuan shkolla të posaçme
për fëmijë shqiptarë, por ky lloj shkollash u suprimua gjatë vite-
ve 1920 deri 1930.⁴³

Ndjekja e dobët e shkollave nga ana e fëmijëve shqiptarë, që
është e kuptueshme sidomos kurr merret parasysh se fëmijët nga
fshati nuk e njihnin gjuhën serbe, solli si pasojë një shkallë shu-
më të lartë të analfabetizmit: më se 90% të popullsisë shqiptare
në këtë trevë ishin analfabetë.⁴⁴

Arsimi dhe kultura ishin në nivel të ulët në Ferizaj dhe në rre-
thinë në kohën e Jugosllavisë borgjeze.

Sipas shënimeve të vitit 1937, rrethi i Nerodimes (Ferizajt)
kishte 36.937 banorë, 23 shkolla popullore (fillore katërklasëshe —
SH.H.), ku mësimet i ndiqnin 3.063 nxënës.⁴⁵

⁴¹ AIUH, Fondi i Arshivës shqiptare, k. 1, f. 4, d. 6; „Lidhja e Prizrenit”,
2. IV. 1944, 2.; Mr. Shaban Hashani, *Systemi i pushtimit fashist në
Ferizaj dhe rrethinë, Kosova*, nr. 7, Prishtinë, 1978, 403.

⁴² AIUH, NAV-T-77, r. 1299, s. 630—43, 1326—8; T-77, r. 613, s. 1800—371—
4; T-84, s. 137408, s. 3—19. (Cit. sipas A. Miletić, *pun. cit.* në „Kosova”, nr.
4, 1975, 284).

⁴³ *Monografia „Ferizaji dhe rrethina*, Beograd, 1975, 245; Nikola
F. Vidacić, *Na obalama Nerodimke*, Novi Sad, 1967, 41.

⁴⁴ Dr. Ali Hadri, *Gjakova prej themelimit deri me 1941*, „Kosova”,
nr. 1, Prishtinë, 1972, 431.

⁴⁵ K. Marković — Jakov Ivanović, *Skolstvo Južne Srbije
od 1912—1937*, „Spomenica 25-godišnjice oslobođenja Južne Srbije 1912—
1937”, Skopje, 1937, 923.

Në periudhën prej vitit 1919 deri 1937 në rrethin e Ferizajt u hapen disa shkolla. Në qytet u hap një shkollë e ulët qytetze e drejtimit të përgjithshëm, pastaj Gjimnazi i Ulët Privat dhe një shkollë fillore. Në komunën e atëhershme të Talinovicit ishin hapur tri shkolla fillore (Starosellë, Talinovic dhe Pojatishtë); në të Kosinës, po ashtu, dy (Slivovë dhe Kosinë); në komunën e Nerodimes ekzistonin tri shkolla (Nerodime, Pleshinë dhe Zaskok); në të Shtimes dy (Shtime dhe Muzeqinë); në të Babushit katër (Babushi Serb, Gadime, Llugaxhi dhe Mirash) dhe në atë të Gaçkës një (në Gaçkë).⁴⁶

Shkolla të mesme nuk kishte, kështu që një numër i vogël nxënësish vazhduan shkollimin jashtë Ferizajt. Vlen të përmendet edhe Shkolla e Ulët e Amvisërisë në Shtime, të cilën e ndiqnin vajzat. Për këtë shkollë të amvisërisë kujdesej shoqata „Knjeginja Ljubica”. Shkolla çdo vit pranonte nga 20 deri 30 vajza, të cilat aty e mësonin amvisërinë. Gjatë tërë ekzistimit të kësaj shkolle nëpër të kaluan vetëm 10 vajza shqiptare.⁴⁷

Të dhëna arkivore për numrin e nxënësve i kemi vetëm për Gjimnazin e Ulët Privat në Ferizaj. Këto të dhëna i takojnë periudhës 1924—1928.

Në vitin shkollor 1924/25 në klasën e parë të këtij gjimnazi mësimet i ndoqen 60 nxënës, prej të cilëve vetëm një ishte shqiptar. Ndërsa në klasën e dytë në të njëjtin vit shkollor mësimet i ndoqen 17 nxënës, në mesin e të cilëve nuk kishte shqiptarë.⁴⁸

Gjatë vitit shkollor 1925/26 prej klasës së parë deri në të katërtën mësimet i ndoqen 170 nxënës, në mesin e tyre edhe 5 shqiptarë.⁴⁹

Në vitin vijues shkollor, 1926/27 në këtë shkollë ishin të regjistruar 182 nxënës, në mesin e të cilëve edhe 14 nxënës shqiptarë.⁵⁰ Dhe më në fund, në vitin shkollor 1927/28, këtë shkollë e ndoqën, po ashtu, 182 nxënës, në mesin e të cilëve edhe 14 nxënës shqiptarë.⁵¹

Në Ferizaj ekzistonte edhe një shkollë fetare — medresja. Për numrin e nxënësve që ndoqën këtë shkollë, posaçërisht shqiptarë, kemi të dhëna vetëm për vitin shkollor 1931/1932, kur në këtë shkollë ishin të regjistruar gjithsej 51 nxënës.⁵²

Mësuesit e shumë shkollave ishin njerëz përparimtarë. Në mesin e tyre vlen të përmendim Bogdan Sharanoviqin, mësues në

⁴⁶ N. VIDAČIĆ, *Na obalama Nerodimke*, 42.

⁴⁷ *Po aty*; Šaban Hashani, *Ferizaji dhe rrethina e tij në Lëvizjen Nacionalçlirimtare 1941—1945*, punim i mbrojtur i magistraturës, Ferizaj, 1979, 32. (dorëshkrim).

⁴⁸ Arkivi i Kosovës në Prishtinë (më tutje vetëm: AK), Fondi Gjimnazi i Ulët Privat në Ferizaj, nr. inv. 1, regjistri i nxënësve të kl. I dhe II për vitin shkollor 1924/1925.

⁴⁹ AK, Fondi i njëjtë, nr. inv. 2, regjistri i nxënësve për vitin shkollor 1925/1926, për kl. I—1, I—2, II—1, II—2, III dhe IV.

⁵⁰ AK, Fondi i cit. nr. inv. 3, regjistri i kl. I, II—1, II—2, III dhe IV për vitin shkollor 1926/1927.

⁵¹ AK, Fondi i cit. nr. inv. 4, regjistri i kl. I, II, III dhe IV për vitin shkollor 1927/1928.

⁵² AK, regjistri i nxënësve të medresës për vitin shkollor 1931/32.

Babush, i cili kishte qëndrim të drejtë ndaj shqiptarëve. Me të shoqërohej Halit Ibishi (gjatë LNÇ-së anëtar i PKJ-së dhe i Komitetit të Rrethit në Ferizaj — SH. H.).⁵² Pastaj ishin të njohur edhe Drago Muçalica, Millosh Vuçkoviçi, Anka Obuçina etj. Drago Muçalicën dhe Anka Obuçinën i gjejmë edhe si delegatë në Kuvendin XIX të Shoqatës Jugosllave të Mësuesve, që u bë në Banjallukë më 19—20 gusht të vitit 1939. Ky është i njohur edhe si Kongresi i Banjallukës, i cili paraqet moment mjaft të rëndësishëm në historinë e luftës së mësuesve përparimtarë të Jugosllavisë, e posaqërisht të mësuesve komunistë dhe simpatizuesve të PKJ-së ndër-mjet dy luftërave botërore.⁵⁴

Për zhvillimin kulturor u hapen biblioteka dhe salla leximi. Këto salla të leximit u hapen kryesisht pranë shkollave fillore, siç janë në Starosellë (1934), Talinoc dhe Tankosiq (1930), Pojatishtë dhe në Kosinë (1937) etj.

Në zhvillimin kulturor të kësaj treve një rol të konsiderueshëm luajtën edhe shoqëritë teatrore amatore. Themelet e seksioneve muzikore, korale, të këngëve dhe të dramave u vunë qysh në vitin 1914, kur u themelua shoqëria e parë korale „Millosh Obiliq”, në gjirin e së cilës ishin përfshirë 25 anëtarë. Në vitin 1927 u themelua Shoqëria e amatorëve serbë të dramës, kurse në vitin 1932 kori i qytetit „Sveti Urosh”.⁵⁵

Të gjitha këto i dedikoheshin rinisë serbe, ndërsa ajo shqiptare, për rrethana veç të njohura, pothuajse nuk mori pjesë në këto shoqëri kulturo-artistike.⁵⁶ Rinia shqiptare nuk kishte të drejtë argëtimi dhe tubimi të organizuar. Mandej asaj nuk i binte ndër mend për argëtim, sepse kishte hallet e jetës. Ajo gjente argëtim më së shumti nëpër ndenja pas darke, nëpër oda ku dhe këndoheshin këngët patriotike me çifteli dhe sharki. Më 1937 në Ferizaj u themelua shoqëria kulturore-artistike „Sharr”, e cila ishte shumë aktive. Kjo ishte e vetmja shoqëri në gjirin e së cilës përfshiheshin edhe disa të rinj shqiptarë.⁵⁷

Shfaqja e parë filmike në Ferizaj u dha në vitin 1928, ndërsa duke filluar nga viti 1937 ato filluan të shfaqen rregullisht. Shfaqja e filmave bëhej në shtëpinë e „Sokolave” (tani ndërtesa e Shtëpisë së kulturës „Hivzi Sulejmani” — SH.H.).⁵⁸

Shoqëria e parë sportive, shoqëria „Sokol”, u themelua qysh më 1908. Detyrë themelore e kësaj shoqërie ishte tubimi i rinjve të të dy gjinive dhe të të gjitha kombësive dhe kultivimi i dasha-

⁵² Kujtimet e Shaban Kajtazit, që i shënoi personalisht autori më 29. V. 1978 në Prishtinë.

⁵⁴ Rade Vučković, *Napredni učiteljski pokret između dva rata*, Pedagoški Muzej, Beograd, 1967, 74 dhe 79.

⁵⁵ *Monografija „Ferizaji dhe rrethina”*, Beograd, 1975, 264.

⁵⁶ Nuk mund të pranohet verbënisht mendimi i Nikolla Vidaçiqit kur shkruan: „Në goftë se ndonjë i ri shqiptar tentonte të bashkëpunonte me të rinjtë serbë, pengohej nga të vjetrit (shqiptarët — SH.H.)”

⁵⁷ Muhamet Piraku, *Lëvizja e Rinisë Komuniste në Kosovë ndër-mjet dy luftërave botërore*, „Rilindja”, 10. II. 1974, 16.

⁵⁸ *Monografija „Ferizaji dhe rrethina”*, 266.

mirësisë. Prej vitit 1921 filloi zhvillimi i kulturës fizike me top këmbë nga nxënësit e gjimnazit.*

Në Jugosllavinë e Vjetër në tërë rrethim ekzistonte një mjek civil, një mjek i ushtrisë dhe një barnatore. Për rajonin malor ishte vetëm një mjek me seli në Shtërpçë, që nga viti 1932.⁶⁰

Me kapitullimin e Jugosllavisë u bënë ndryshime edhe në sferën e arsimit dhe të kulturës. Fashistët italianë bënë përpjekje ta organizonin fashizimin e kësaj treve, sidomos me anë të politikës kulturo-arsimore. Për këtë qëllim, si dhe për ta paraqitur vetveten si „qytetëruës” të shqiptarëve, ata favorizuan hapjen e shkollave ekskluzivisht në gjuhën shqipe.⁶¹ Në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme mësoheshin lëndët: kultura fashiste dhe gjuha italiane. Qysh në janar të vitit 1940, me një qarkore të Ministrisë së Arsimit nr. 434 të dt. 24. I. 1940, dërguar shkollave të mesme në Shqipëri, shihet se ishte futur lënda mësimore „Doktrina fashiste e shtetit”. Njëherësh urdhëroheshin shkollave që për këtë lëndë mësimore të përdorej libri i shkruar nga autorët italianë dhe i botuar në Itali.⁶² Lënda mësimore „Kultura fashiste” ishte futur qysh në klasat e shkollës fillore, ku me planprogram parashihej edhe një njësi mësimore me titull „Figura e Duçes (Benito Musolinit — shën. SH.H.) si shpëtimtar i Shqipërisë”,⁶³ si dhe pjesë nga biografia e Duçes.⁶⁴ Po ashtu, festohej edhe datëlindja e sundimtarëve të Italisë fashiste. Një festim i datëlindjes së mbretit të Italisë, Emanuelit III, ishte organizuar edhe në shkollat e Ferizajt, më 2. XI. 1942.⁶⁵

Pas pushtimit të Kosovës nga fashistët italianë, këto planprograme të kulturës fashiste filluan të aplikohen edhe në shkollat e posahapura të kësaj treve. Fashizmi i caktoi për detyrë „shkollës së re” në Kosovë që ta italianizonte popullsinë shqiptare dhe të përhapte jo vetëm ideologjinë fashiste, por edhe ndjenjat nacionaliste shqiptaromëdha. Kjo shihet më së miri në qarkoren e Ministrisë së Arsimit të Mbretërisë Shqiptare nr. 4529, të datës 25. X. 1941 dhe nr. 12 të datës 10. I. 1943, e edhe nga artikulli „Misioni historik i shkollave në Kosovë në përhapjen e irredentizmit shqiptar dhe në arsimimin në frymën e re” (në frymën e fashizmit — shën. i dr. Ali Hadrit). Të gjitha tekstet shkollore ishin të shkruara në frymën e ideologjisë shqiptaromadhe.⁶⁶

Në vitin 1942 u hapen kurset e para të gjuhës shqipe për të rritur. Pos fëmijëve që më parë nuk ishin përfshirë nëpër shkolla, këto kurse i ndiqnin edhe një numër hoxhollarësh, nëpunësish, të cilët kishin qenë nëpunës edhe në Jugosllavinë e Vjetër e që nuk

⁶⁰ Po aty, 269.

⁶¹ N. Vidačić, *Na obalama Nerodimke*, 45.

⁶² Si shënimi 4. 115.

⁶³ „Shkolla shqiptare”, viti III, nr. 33, 1—15 Fruer, 1940, 212.

⁶⁴ „Shkolla shqiptare”, viti III, nr. 37, 1—15 Prill, 1940, 384.

⁶⁵ „Shkolla shqiptare”, viti III, nr. 32, Kalenduer, 1940, 16—31.

⁶⁶ AK, Fondi Shkolla fillore e Ferizajt 1942—1944, d. XXIV—K. 1—55—1942.

⁶⁶ Si shën. 33.



MBRETNIA SHQIPTARE

SHKOLLA FILLORE "Imail Qemali" Ferizaj
PREFEKTURA e Ferizajt VJETI SHKOLLOR 1942-43
INSPEKTORIA E ARSIMIT "Pishtinë" Nr. I AMZES 248

DËFTESË LIRIMI

Me anën e kësaj dëshmohet se nxënësi Hajriz Jakupi
i emri i Mushiut dhe i Sahide së
lindun më 23-Gusht-1923 në Budakerrë, ka ndjekë
rregullisht mësimin e kësaj shkolle, dhe, si i u shtrua provimit për të
marre detyren e lirimil, fitoi këto nota:

- Në sjellje Shimbëllore (1)
- Në kujdes I lardueshem (1)
- Në pastri Shimbëllore (1)

LANDET	NOTAT
Edukate morale e qytetare	shume mire (1)
Gjuhë shqipe	shume mire (1)
Arithmetikë e Gjeometri	mire (2)
Histori	shume mire (1)
Gjeografi	shume mire (1)
Histori natyre - Dituri Natyre	shume mire (1)
Duqësi	()
Vizatim e Bukurshkrim	shume mire (1)
Punë dore e punë gjylypan	()
Kënga	mire (2)
Edukate fizike	shume mire (1)

Ferizaj me 26-VI - 1943

Komisjoni-Provues

ANTARËT
D. P. L. ...

Vërtetohet

SHKOLLA MBRENETARE
KRYETARI

Dëftesë e shkollës fillore lëshuar më 1943 në Ferizaj

e njohin shkrimin dhe leximin shqip etj. Në këto kurse në Kosovë u përfshi edhe një numër i xhandarëve. Këso kursesh u hapen edhe në Ferizaj, Shtime⁶⁷ dhe Talinoc. Një ndër theksimet kryesore të këtyre shkollave ishte sesi të mësohej gjuha shqipe më mirë. Në lidhje më këtë në disa revista dhe gazeta të kohës shkruante:

„Mësimi i gjuhës shqipe në shkollat fillore të „viseve të çliruar“ (mendohet për trevën e Kosovës, Maqedoninë Perëndimore dhe për disa vise të Malit të Zi — shën. SH.H.) është puna kryesore dhe problemi teknik më i vështirë që u rri për ballë mësuesve të atyre anëve”.⁶⁸

Pos kurseve për fëmijë të rritur-analfabetë në Kosovë, përkatësisht në Ferizaj, ishin hapur edhe disa kurse të punës së dorës, ku kryesisht ishin përfshirë femrat.⁶⁹

Sipas disa të dhënave del se në zonën okupuese italiane të Ferizajt ishin hapur 11 shkolla fillore, ndërsa shkolla të mesme nuk kishte fare. Këto shkolla ishin të hapura në Ferizaj: („Ismail Qemali”),⁷⁰ Shtime, Gadime (tani ky fshat i takon komunës së Lipjanit — shën. SH.H.), Nerodime, Bibaj, Slivovë, Talinoc, Mirash, Llugaxhi (tani komuna e Lipjanit — SH.H.), Pleshinë⁷¹ dhe Greme.⁷² Pos shkollës fillore në Ferizaj, që ishte pesëklasëshe, të gjitha të tjerat ishin katërklasëshe.⁷³ Qendra e Drejtorisë së këtyre shkollave ishte në Ferizaj. Në mbështetje të të dhënave që posedojmë mund të rekonstruktojmë përafërsisht pasqyrën e personelit mësimdhënës gjatë vitit shkollor 1942/43.

Drejtorë të shkollës në Ferizaj dhe njëherësh për të gjitha shkollat e tjera të fshatrave ishin Ismet Shaqiri dhe Petro Papakosta.⁷⁴ Si mësues, pos këtyre që u përmendën si drejtorë, në këtë shkollë shërbyen edhe Fadil I. Hoxha, Ymer Sypheja, Gjina Karasani, Bashkim Karagjozi dhe Shaban Shaqiri-Vata. Në Shtime si mësues përmenden Koço Shukallari dhe Enver Juzufati; në Gadime Ruzhdi Guranjaku dhe Kadri Greca; në Nerodime Ferid Buza; në Bibaj Engjëll Zefi dhe Angjell Z. Noka; në Slivovë Shaban Shaqiri-Vata, Mujo Sokoli e më vonë edhe Gjeto Leka; në Talinoc Rrahman Palushi dhe Abdullah Laçi; në Mirash Jusuf Rexhepi, në Llugaxhi Jusuf Ramadani; në Pleshinë Idriz Ajeti-Gashi (përkohësisht — SH.H.) dhe Asaf Peshkopia, dhe në Greme Idriz Ajeti-Gashi (prej 1943 anëtar i PKJ-së dhe i varur nga nazistët gjermanë në Prizren në gusht të vitit 1944 — SH.H.)⁷⁵

⁶⁷ AIUH, Arshiva shqiptare, k. 1, f. 3—3, d. 4; „Kosova”, Fruer, 1943, Viti II, Nr. 42—43, 6; „Shkolla shqiptare”, Vjeti V, Nr. 52, Tetuer, 1942, 3.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ „Shkolla shqiptare”, Vjeti V, Nr. 52, Tetuer 1942, 11, 12, 13.

⁷⁰ „Shkolla shqiptare”, pa datë.

⁷¹ AK, Fondi Shkolla fillore në Ferizaj 1942—1944, d. LXIV—K. 1—49—1942, Lista e shkollave fillore dhe e mësuesve të paraqitur në detyrë për vitin shkollor 1942/43.

⁷² AK, Fondi Shkolla fillore në Ferizaj, d. LXIV—K. 1—30—1943.

⁷³ AK, Fondi i cit. Raporti i Shkollës Fillore të Ferizajt dërguar Inspektorisë së Arsimit në Prishtinë më 30. III. 1943.

⁷⁴ AK, Fondi i Shkollës fillore në Ferizaj, d. LXIV—k. 1-30-1943; d. LXIV—K. 1—62—1943.

Një numër i këtyre mësuesve ishin nga Shqipëria. Por, kishte edhe nga qytetet e tjera të Kosovës, si dhe nga vetë qyteti i Ferizajt. Nga Ferizaji, p.sh., ishte mësuesi Shaban Shaqiri-Vata.

Numri i nxënësve të përfshirë nëpër këto shkolla nuk ishte aq i madh. Në këtë kohë kishte shumë raste kur numri i nxënësve të regjistruar ishte mjaft i madh, por mësimin e vijonin rregullisht një numër fare i vogël. Kështu, në një raport të shkollës fillore në Ferizaj, në nëntor të vitit 1942 shihet se ishin të regjistruar 496 nxënës (272 meshkuj dhe 224 femra), ndërsa shkollën e ndoqën rregullisht 242 nxënës (172 meshkuj dhe 70 femra).⁷⁵ Të dhëna të këtij lloji kemi edhe për shkollën fillore në Slivovë, ku në një raport të kësaj shkolle për vitin shkollor 1942/43 shkruan se janë të regjistruar 90, ndërsa mësimin e vijojnë rregullisht 30 nxënës. Gjithashtu në raportin përkatës shkruan se ky mosvijim, sidomos i femrave, është rezultat i fanatizmit të popullit.⁷⁷

Kushtet e punës në këto shkolla ishin mjaft të vështira. Godinat shkollore diku-diku ishin në gjendje të mjerueshme. Në gjendje të tillë ishte, p.sh., shkolla fillore në Bibaj, Mirash, Pleshinë etj.⁷⁵ Kjo situatë njëherësh na jep të kuptojmë se pushtuesit italianë së bashku me kuislingët shqiptarë në njëfarë dore nuk i jepnin aspak rëndësi përmirësimit të kushteve që këto shkolla të punonin në kushte normale.

Në disa shkolla fillore të Nënprefekturës së Ferizajt mësimet në gjuhën shqipe i ndiqnin edhe një numër i fëmijëve të kombësisë serbe. Për këtë dukuri të dhëna kemi vetëm për shkollën fillore „Ismail Qemali” në Ferizaj, ku në Amëzën e nxënësve, më 15. VIII. 1943, figuron se ishin të regjistruar gjithsej 313 nxënës. Nga kjo amzë shohim se prej këtij numri 18 nxënës ishin të kombësisë serbe.⁷⁹

Në mbështetje të të dhënave mund të themi se pos në shkollën fillore në Ferizaj, ku ishte përfshirë një numër i konsiderueshëm femrash, nëpër shkollat e fshatrave numri i femrave të përfshira ishte pothuajse simbolik ose nuk ishin përfshirë fare. Kjo gjendje shihet edhe nga një raport i Shkollës Fillore të Ferizajt dërguar Inspektorisë së Arsimit në Prishtinë, nr. 132/I dt. 30. III. 1943, ku në shkollat e fshatrave Talinocv, Nerodime, Pleshinë, Mirash, Llugaxhi, Greme dhe Bibaj, prej 291 nxënësve të regjistruar, kishte vetëm 13 femra.⁸⁰

Megjithëse këto shkolla i hapi pushtuesi italian dhe punuan sipas planeve të politikës italiane, në to disa mësues ishin të lidhur dhe morën pjesë aktive në Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe

⁷⁵ AK, Fondi i njëjti, d. LXIV—K. 1—49—1942; d. LXIV—K. 1—30—1943; d. LXIV—K. 1—34—1942.

⁷⁶ AK, d. LXIV—K. 1—34—1942.

⁷⁷ AK, Fondi i njëjti, d. LXIV—K. 1—34—1943.

⁷⁸ *Po aty*; Shaban Hashani, *Ferizaji dhe rrethina e tij në LNÇ 1941—1945*, punim i mbrojtur i magjistraturës në dorëshkrim, Ferizaj, 1979, 174.

⁷⁹ AK, i njëjti fond, Amëza e nxënësve prej 15. VIII. 1943, nr. in. 1.

⁸⁰ AK, i njëjti fond, raporti i Shkollës fillore të Ferizajt dërguar Inspektorisë së Arsimit në Prishtinë më 30. III. 1943.

bënë agjitacion për të jo vetëm ndër nxënës, por edhe ndër popullsi nga pozitrat ideore të PKJ-së.⁸¹ Ky aktivitet i këtyre mësuesve antifashistë u hetua edhe nga armiku i Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Kjo shihet edhe në një qarkore të Inspektorisë së Arsimit në Prishtinë, nr. 642 dt. 7. XI. 1942, dërguar të gjitha shkollave. Me këtë qarkore mësimdhënësve u ndalohej qarkullimi i lirë. Në lidhje me këtë në qarkore shkruan:

„Është vënë re se ndonjë nga arsimtarët e sidomos nga ata të fshatrave lëviz nga vendshërbimi pa leje. U bëhet me dije edhe një herë të gjithë arsimtarëve (...) se asnjë nëpunës nuk rind të lëvizë pa leje nga vendshërbimi... Bën përjashtim vetëm ndonjë rast urgjent i jashtëzakonshëm dhe kjo e vërtetuar me dokument”⁸²

Me anën e kësaj qarkoreje „arsimtari nga fshati mund të vinte në qytet vetëm për të marrë rrogën, një herë në muaj”.⁸³

Pastaj në qarkore pasonin kërcënimet për ata arsimtarë që nuk i përmbaheshin këtij urdhri. Në lidhje me këtë në qarkore shkruante:

„Shkollat në Gjilan dhe në Ferizaj do të na bëjnë me dije telegrafisht mbi largimin nga vendi i shërbimit të çdo arsimtari; ndryshe edhe titullarët e atyre shkollave (mendohet për drejtorët e shkollave — shën. SH.H.) do të kenë përgjegjësi pasi ato janë të njohura edhe nga Ministria e Arsimit si shkolla Koresponduese.

Besojmë të mos persëriten raste të tilla që të na vënë në pozitë përgjegjësie duke na shtrënguar të marrim masat që u përmenden sipri sipas urdhrave të prerë që kemi nga Ministria”.

Një qarkore gati me përmbajtje të njëjtë me atë që përmenden u ishte dërguar, pos prefekturave dhe nënprefekturave, edhe shkollave në Ferizaj, nr. 78, 84 dhe 58 dt. 19 dhe 21. I. 1943. Me anën e kësaj qarkoreje u tërhoqet vërejtja këtyre institucioneve arsimore duke shkruar se „Kombi ynë është kah kalon një krizë shpirtërore ndër më të mëdhaja që historia e tij shëjon. Grupe të ndryshme të çdo klase e moshe braktis detyrë e shtëpi e të rrejtur prej propagandës së armiqëve tonë (mendohet në propagandën komuniste — shën. i SH.H.) po bëhen pa dashtur shkaktarë: trazirash e veprat e tyre do të sjellin dëme të mëdhaja (mendohet për dëmet që komunistët dhe partizanët u shkaktorin fashistëve italianë dhe bashkëpunëtorëve të tyre — shën. i SH. H.)”⁸⁵

Për t'i larguar mësimdhënësit nga aktiviteti i tyre për Lëvizjen Nacionalçlirimtare, Federata e Fashit në Prishtinë, nëpërmjet Inspektorisë së Arsimit, u kishte dërguar shkollave një qarkore

⁸¹ Monografia „Ferizaji dhe rrethina”, Beograd, 1975, 247.

⁸² AK, Fondi Shkolla fillore në Ferizaj 1942—1944, d. LXIV—K. 1—62—1942, Qarkore e Inspektorisë së Arsimit në Prishtinë dërguar të gjitha shkollave më 7. XI. 1942.

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Po aty.

⁸⁵ AK, Fondi Shkolla fillore në Ferizaj, d. LXIV—K. 1—19—1943, Qarkore dërguar të gjitha prefekturave dhe nënprefekturave dhe shkollave, nr. 78, 84 dhe 58, dt. 19 dhe 21. I. 1943.

Nr. 21/1 dt. 13. I. 1943. Në këtë qarkore thuhej se „Ka dalë në qarkullim numri i parë „Balli i Rinisë”, organ i B.R.U.F.SH. (Bashkimi i Rinisë së Unjësuar Fashiste Shqiptare) dhe se duhet të parapaguhen mësimdhënësit e shkollave”.⁸⁶

Aktiviteti i mësuesve antifashistë, sidomos i nxënësve të shkollave të mesme shihet edhe nga qarkorja e Ministrisë së Arsimit nr. 1673, Tiranë, më 16. IV. 1943. Kjo qarkore u drejtohej sidomos prindërve të nxënësve, ku, pos të tjerash, thuhej: „Ka disa vjet që shkolla jonë kombëtare është bërë shesh veprimesh politike, çerdhe shqetësimi e turbullimi, çerdhe e çdo propagande (mendohet për propagandën komuniste, e cila bazat e veta i kishte krijuar edhe në shumë shkolla — shën. i SH.H.) si „shkatronjëse” me ngjyrë të huaj me qëllime të „errta”.⁸⁷ Sa qesharake dhe pa kurrfarë baze ishte kur thuhej se „ne jemi ndër vendet më të qeta e të paprekura drejtpërdrejt nga lufta”.⁸⁸ Në qarkore pastaj cekej edhe „shkaktari” i këtij mjerimi të popullit. Në lidhje me këtë në qarkore shkruante: „Si shtytës i këtij mjerimi dhe turbullirave (mendohet për demonstratat antifashiste gjatë LNC-së — shën. i SH.H.) fajtor është personeli arsimor”.⁸⁹

Fanatizmin që kishte zhvilluar sidomos kleri të fshatarësia që fëmijët, e sidomos femrat, të mos dërgoheshin nëpër shkolla, qarkorja në fjalë përpiquej që këtë mosvijim të një numri të konsideruar nxënësish ta „arsyetonte” më një ngjyrë tjetër duke shkruar se gjoja nga „këto turbullira dhe rrethana shumë prindër janë deytuar t’i largojnë fëmijët e vet duke preferuar injorancën e mëparshme para rrezikut të një infektimi mendor, shpirtëror dhe trupor të tyre”.⁹⁰

E tërë kjo propagandë fashiste nuk mundi të ndikonte që një numër mësuesish të shkollave të nënprefekturës së Ferizajt të largohej nga veprimtaria e tyre antifashiste, përkatësisht nga Lëvizja Nacionalçlirimtare. Prej mësuesve që punuan në terrenin e Ferizajt më aktivë dhe anëtarë të PKJ-së ishin Ismet Shaqiri, Idriz Ajeti-Gashi etj. Për veprimtarinë e tij komuniste Ismet Shaqiri u burgos më 2 mars të vitit 1943.⁹¹

Aktivitetin komunist të mësuesit tjetër, Idriz Ajetit-Gashit e kishin hetuar organet fashiste qysh në prill të vitit 1943, kur ai shërbente si mësues në fshatin Greme. Qysh më 9 prill komuna e Gremes e njoftonte nënprefekturën në Ferizaj me shkresë Nr. 107 sa vijon:

„Kemi nderin t’u njoftojmë se mësuesi i shkollës fillore në Greme z. Idriz Ajeti, aspak nuk e respekton orarin zyrtar, por gj-

⁸⁶ AK, Fondi Shkolla fillore në Ferizaj, d. LXIV—K. 1—17—1943.

⁸⁷ AK, Fondi i njejt, d. LXIV—K. 1—57—1943, Qarkore për prindërit e nxënësve të shkollave të mesme, Nr. 1673, dt. 16. IV. 1943, Tiranë.

⁸⁸ Po aty.

⁸⁹ Po aty.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ AIHK, K—15/1, nr. 184, Shënimet stenografike për historinë e PKJ-së në rrethin e Nerodimës (Ferizajt); Ismet Shaqiri, *Më kujtohet...*, Prishtinë, 1977, 329.

thnjë ndodhet në Ferizaj, pa ardhur në fshat dy herë në javë, ashtu që fëmijët vijnë në shkollë, mësuesi jo, dhe tani nuk kanë vullnet të vijnë edhe fëmijët.

Prandaj ju lutemi të merren masat ligjore kundër mësuesit në fjalë”⁹²

Nga kjo e dhënë mund të nxjerrim faktin se mësuesi Idriz Ajeti-Gashi në këtë kohë zhvillonte një aktivitet të madh për Lëvizjen Nacionalçlirimtare sa shpesh edhe mungonte nga detyra e mësuesisë me vendshërbim në fshatin Greme.

Lëvizjen Nacionalçlirimtare e ndihmuan ose marrë pjesë aktive në të edhe mësues të tjerë që shërbyen nëpër shkollat e nën-prefekturës së Ferizajt, siç ishin: Rrahman Palushi, Jusuf Rexhepi, Petro Papakosta, Bashkim Karagozi, Mujo Sokoli, Gjeto Leka, Shaban Shaqiri-Vata. Me këtë grup mësuesish u organizuan kontakte, qoftë me secilin veç e veç ose me të gjithë së bashku. Një numër i këtyre mësuesve i takonte grupit antifashist me të cilin punonte Shaban Kajtazi. Këta mësues ishin mjaft aktiv si ata që shërbenin në qytet, ashtu edhe ata që shërbenin nëpër fshatra.⁹¹ Pos Ismet Shaqirit edhe Idriz Ajeti-Gashit, anëtarë të PKJ-së kanë qenë pranuar edhe mësuesit Petro Papakosta dhe Bashkim Karagozi. Grupi prej katër anëtarësh: Halit Ibishi, Idriz Ajeti-Gashi, Petro Papakosta dhe Bashkim Karagozi ishin grup intelektualësh i organizuar i Partisë, i cili përhapte me guxim idetë përparimtare ndër të rinj dhe fshatarë të Ferizajt.⁹¹

Derisa në zonën okupuese italiane u hapen shkolla, në atë bullgare të Ferizajt kjo nuk ndodhi. Në të vërtetë, fashistë bullgarë qysh në fillim tentuan të hapnin shkolla në gjuhën bullgare me qëllim që ta bullgarizonin popullsinë e Rrafshit të Siriniqit. Por, kjo tentativë dështoi për arsye se populli i kësaj treve nuk regjistroi asnjë fëmijë në këto shkolla, përkatësisht e bojkotoi hapjen e tyre. Prandaj gjatë tërë kohës së okupacionit në zonën okupuese bullgare nuk u zhvillua kurrfarë aktiviteti arsimor dhe kulturor.⁹⁵

Një gjendje e tillë në sferën e arsimit zotëroi edhe pas kapiullimit të Italisë fashiste.

Në Ferizaj ishte e dobët edhe jeta kulturo-artistike. Punonte vetëm kinemaja që jepte filma italianë, në të cilët hiperbolizoheshin sukseset ushtarake të Musolinit dhe të Hitlerit. Repertoari i filmit kishte për qëllim të justifikonte synimet zaptuese të Gjermanisë dhe të Italisë dhe të mbilte frikën te popullsia e vendit në mënyrë që ta ndante nga Lëvizja Nacionalçlirimtare. Aktiviteti ilegal i PKJ-së në Ferizaj dhe në rrethinë ishte aq i fuqishëm, sa që

⁹² AK, Fondi Shkolla fillore në Ferizaj, d. LXIV—K. 1—52—1943.

⁹³ *Rad osnovne partijske jedinice u Uroševcu od početka 1943. godine sastavljena od šiptara* (dorëshkrim), fotokopja e këtij dokumenti gjendet te autori i këtij punimi.

⁹⁴ *Po aty*.

⁹⁵ AIHK, K—15/1, nr. 184, Shënimet stencografike për historinë e PKJ-së në rrethin e Ferizajt më 22. III. 1955 (deklaratë e Ismet Shaqirit); Ismet Shaqiri, *Më kujtohet...*, 272—273; Po ai, në „1941—1942 u svedočenjima učesnika NOB-a”, knj. 15, Beograd, 1975, 133.

frekuentimi i shfaqjeve filmike ishte shumë i dobët. Që nga viti 1942 shfaqjet e filmave u dhanë në magazinën e Drageta Galicëviçit. Salla kishte 300 vende, por nuk mbushej plot.⁹⁶

Gjatë luftës u shfaq edhe ndonjë shfaqje teatrale, që i organizonin tradhtarët në shërbim të okupatorit dhe sipas porosisë së tij. Por, Lidhja e Rinisë Komuniste e Jugosllavisë përgatiste aksione që kishin për qëllim që në ato shfaqje t'i vërë në tallje okupatorin dhe shërbëtorët e tij.⁹⁷

Në Ferizaj gjatë okupacionit nuk pati kurrfarë manifestimesh sportive. meqë rinia nuk i përqafohte, por i kundërshtonte me gjithë orvatjet e okupatorit të organizonte disa manifestime sportive, sidomos ndeshjet futbollistike.⁹⁸

Nga kjo që u tha më lart mund të konstatojmë se në Ferizaj dhe në rrethinën e tij, posaqërisht në zonën okupuese italiane, anë pozitive ishte hapja e shkollave në gjuhën shqipe, ndërsa anë negative ishte sepse kombeve të tjera në këtë trevë iu mohohej shkollimi në gjuhën amtare. Roli pozitiv i këtyre shkollave qëndron edhe në faktin për herë të parë populli shqiptar i kësaj treve filloi të mësonte shkrim dhe lexim në gjuhën amtare. Edhe pse fashistët u përpoqën që këto shkolla të jenë instrument i përshtatshëm për fashizimin e popullit shqiptar, ato së shpejti u shndërruan në çerdhe të LNÇ-së. Kjo gjë u arrit sidomos në sajë të mësimdhënësve të këtyre shkollave, shumica e të cilëve ishin inkuadruar në LNÇ dhe si të tillë i qëndruan besnik idealit komunist.

Mr. Shaban Hashani

LES CIRCONSTANCES ÉCONOMIQUES, CULTURELLES
ET EDUCATIVES À FERIZAJ ET DANS SES ENVIRONS
DE 1918 À 1945

R é s u m é

Ferizaj et ses environs était une contrée très arriérée au point de vue économique. Pendant les deux guerres mondiales il eut eu quelques petites entreprises industrielles avec un artisanat bien développé. Une bonne partie de la population de Ferizaj s'occupait de l'élevage et de l'agriculture quoique la ville se situait au carrefour des routes.

Après l'occupation du pays, les fascistes pillaient le pays, cela arrive même à Ferizaj. Un des établissements importants de Ferizaj était *SASTEB*, -association commerciale qui s'occupe de l'achat du blé de la part du peuple

⁹⁶ Deklaratë e Bogdan Zhivkoviçit, Dragolub Dobrosavleviçit dhe Rista Stanojkoviçit dhënë autorit në Gotovushë më 2 I. 1978; Deklaratë e Stoilko Staletoviçit më 26. III. 1978; Kujtimet e Nazif Rushitit dhe të Fejzullah Shahinit më 7. VI. 1978

⁹⁷ *Monografia „Ferizaji dhe rrethina”, 264 dhe 266.*

⁹⁸ *Po aty, 264.*

afin de le remettre à l'occupant. Pour l'occupant, les mines du chrome ont été très importantes „Jezerina” — près de Shtërpce.

Pendant l'ancienne Yougoslavie, l'enseignement et la culture étaient au niveau assez bas en serbocroate tandis que les cours fréquentaient un petit nombre d'élèves albanais.

Au temps de l'occupation, dans la zone envahie par les Italiens surtout dans la zone allemande furent ouvertes des écoles où l'enseignement se faisait uniquement en albanais, tandis que dans la zone occupée par les Bulgares, elles ne fonctionnaient pas.

Quoique les écoles étaient ouvertes par les occupants italiens et allemands elles travaillaient d'après le plan et le programme de la politique italienne et allemande. Là il y avait des instituteurs qu'ils étaient liés et avaient participé au Mouvement de la résistance nationale, et avaient fait des propagandes non seulement parmi les élèves, mais dans la population aussi sur des positions idéo-politiques du P.C.Y.